



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.486/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ndërmarrja për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina” me seli në Novisad, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.D., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.252/2018 të datës 02.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Ndërmarrja për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina” me seli në Novisad, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative, A.nr.252/2018, i datës 02.04.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar A.nr.252/2018, i datës 02.04.2021, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Ndërmarrja për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina” me seli në Novisad, me të cilin ka kërkuar që të anulohet aktvendimit nr. 03/258/17 datë 10.01.2018 dhe aktvendimi nr. 03/258/17 datë 24.12.2019 i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të obligohet e paditura që të bëjë regjistrimin e njësisë

katarrtrale me nr. 0-71914059-06219-2-030-0, ne sipërfaqe prej 36m2, e identifikuar si zyra administrative në bazë të kontratës për ndërrimin nr. 04-814 datë 27.03.1969, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljeve të rënda të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të aprovoj në tërësi ankesën e paditësit Ndërmarrjes për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvoda” me seli në Novisad, të cilin e përfaqëson A.D., avokat nga Prishtina me adresë Rr. UÇK hyrja 68 nr. 1 Prishtinë si e pa bazuar, të prishet aktgjykimi A.nr. 252/2018 i datës 02.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që i njëjti ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit aprovohet në tërësi.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjen se;

Ankesat janë të pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Aktvendimin nr. 03/258/17 datë 10.01.2018 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr. 03/258/17 të datës 05.12.2017 e Ndërmarrjes për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina” me seli në Novisad, kundër aktvendimit me nr. 011-463-2/1141/17 të datës 24.07.2017 i nxjerr nga Drejtoria për Kadastër Komuna e Prishtinës, dhe mbetet në fuqi aktvendimi me nr. 011-463-2/1141/17 i datës 24.07.2017 i nxjerr nga Drejtoria për Kadastër e Komunës së Prishtinës, me të cilin janë pezulluar veprimet juridike lidhur me bartjen e pronësisë në njësinë kadastrale nr. O-71914059-06219-2-138-0-30-0, pjesa e pronës 1/1 ZK. Prishtinë. Ndërsa me aktvendimin 03/258/17 të datës 24.12.2019 është refuzuar si e pa bazuar ankesa me nr. 03/258/17 e datës 14.02.2019 e parashtruar nga Ndërmarrja për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina” me seli në Novisad kundër aktvendimit me nr. 011-952-1-1141/15 të datës 21.01.2019 të Drejtorisë për Kadastër të Komunës së Prishtinës.

Paditësi, i pa kënaqur me këtë Aktvendim ka ushtruar padi në procedurë të konfliktit administrativ, me të cilin e ka kundërshtuar të njëjtit dhe ka kërkuar anulimin e tij. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor me dt.02.04.2021, në prani të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim të aktgjyimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se Gjykata nga provat të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit kryesor ka konstatuar se bazuar në përgjigjen e datës 13.01.2017 nr.552/17 ku theksohet se Ndërmarrja për Autotransport dhe Shpedicion Ndërkombëtar “Vojvodina”, me seli në Novisad, në data bazë, gjegjësisht në regjistrin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit momentalisht nuk është e regjistruar si Ndërmarrje Shoqërore, duhet të bëhet hulumtimi rreth dokumenteve të dhura nëse ky subjekt bie nën administrimin e AKP. Po ashtu referuar përgjigjes së Ndërmarrjes Publike Banesore ku konstatohet se lidhur me lëndën ka hasur probleme gjatë verifikimit të dokumentacionit dhe përgjigjja lidhur me çështjen do të vonohet, në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjykata ka konstatuar se nuk është shkelur ligji në dëm të këtui paditësit andaj edhe vendimi i datës 10.01.2018, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i shkallës së dytë respektivisht e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtës materiale, kur ka refuzuar ankesën e paditësit të ushtruar kundër organit administrativ të shkallës së parë me të cilin vendim datë 24.07.2017 pezullohen veprimet juridike –administrative të ndërmarra lidhur me bartjen e pronësisë në njësinë kadastrale-banesën me nr.0-71914059-06219-2-138-0-30-0 me sipërfaqe 53.73 m², pjesa e pronës 1/1 sipas Kontratës për ndërrimin e banesës dhe të lokalit afarist lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë nr.04-814, datë 27.03.1969. Duke pasur parasysh komunikimin e NPB datë 17.06.2019 ku konstatohet mes tjerash se kontrata mbi ndërrimin e pasurive nuk mund të thuhet se përfaqëson titull juridik derisa nuk mund të konfirmohet se janë përmbushur obligimet kontraktuale në mes të palëve nënshkruese të kontratës. NPB nuk ka njohuri për banesën në Beograd e cila është objekt i ndërrimit të kontratës. Kontrata e tillë nuk është gjetur fare në arkivin e NPB edhe se vërtetimi nr.02-683 datë 31.03.2015 lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore nuk mund të konsiderohet se është në rregull, në këtë kuptim referuar gjendjes faktike të vërtetuar para organit administrativ dhe kërkesës së këtui paditësit në regjistrimin e njësisë kadastrale në zbatim të kontratës për ndërrimin e banesës dhe të lokalit afarist të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë nr.04-814 datë 27.03.1969 dhe vërtetimit të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore nr.02-683 datë 31.03.2015, duke mos ofruar prova shtesë edhe vendimi 24.12.2019 referuar nenit 3.4 të Ligjit nr.200/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave

të Pronës së Paluajtshme, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i shkallës së dytë respektivisht e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtës materiale, kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Paditësi edhe para gjykatës nuk ka arritur të ofroj prova me ndikimi me të cilën do të mbështeste pretendimet e tij dhe të cilat do të ndikonin në një vendim ndryshe nga ky në dispozitivin e vendimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e aprovon si të rregullt, ligjor dhe të drejtë, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit të 194 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë, sipas kompetencës nga LKA, ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, të ankimuar me padi i cili vendim i ka të parapara argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar e të cilat kolegji i miraton si të drejta dhe të bazuara në ligj, sepse në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike administrative sipas provave të administruara ka vlerësuar me të drejtë se kërkesa e paraqitur nga paditësi për regjistrimin e pronës së paluajtshme, nuk është mbështetur në prova relevante siç parashihet me nenin 3.2 të Ligjit nr.2002/5, për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, ku kërkesës është dashur ti bashkëngjij provë me të cilën e mbështet kërkesën e tij si në vështrim të nenit 4 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (Ligji nr.04/L-009), me të cilin nen riformulohet dhe ndryshohet neni 3 parag.3.7 i ligjit bazik. Sipas këtij neni është përcaktuar se regjistrimi i paluajtshmërisë regjistrohet në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, vendimit të organit administrativ shtetëror kontratës për bartjen e paluajtshmërisë të vërtetuar nga organi kompetent, vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuar nga AKP-ja, vendimit të komisionit për rindërtimin e kadastrit apo të rregullimit të tokave dhe dokumentit tjetër që me ligj të veçantë parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore, të cilat prova paditësi nuk ka mundur ta argumentoj se e ka plotësuar as para organit të paditur e as para gjykatës.

Pretendimet ankimore, se e paditura dhe Gjykata e shkallës së parë, nuk e kanë vërtetuar mirë gjendjen faktike dhe se nuk është lëshuar fare në vlerësimin e tyre. Këtë pretendim kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i refuzon si të pa bazuar për faktin se Agjencia Kadastrale e Kosovës

dhe Gjykata e shkallës së parë, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike për arsye se nga përgjigja e datës 13.01.2017 e Ndërmarrjes Publike Banesore është konstatuar mes tjerash se kontrata mbi ndërrimin e pasurive nuk mund të thuhet se përfaqëson titull juridik derisa nuk mund të konfirmohet se janë përmbushur obligimet kontraktuale në mes të palëve nënshkruese të kontratës. NPB nuk ka njohuri për banesën në Beograd e cila është objekt i ndërrimit të kontratës. Po ashtu kontrata e tillë nuk është gjetur fare në arkivin e NPB dhe se vërtetimi nr.02-683 datë 31.03.2015 i lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore nuk mund të konsiderohet se është në rregull. Në këtë kuptim, edhe Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoj edhe pretendimet e tjera të paditësit dhe të palës së interesit si në ankesë, por që të njëjtat ishin të pa mjaftueshme për një vendim ndryshe, për arsye se vendimi nga organi administrativ dhe ai i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, i ligjshëm dhe i mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore, andaj kolegji i kësaj gjykate e aprovoj si të tillë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Dhoma e Shkallës së Dytë, konstaton se në këtë çështje administrative nga gjykata e shkallës së parë dhe nga organi administrativ i paditur, në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet në ankesë nuk i aprovoi dhe i vlerësoi si të pa ndikim për të vendosur në mënyrë tjetër nga ajo që është vendosur me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.486/22, me datë 11.12.2023

Kryetare kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri